

VENDIM
Nr. 585, datë 25.9.2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR. 1, ME SHKËMBIM
LETRASH TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN PËR LEHTËSIMIN E TREGTISË DHE TË
TRANSPORTIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR, ME QASJE PROGRAMATIKE
ME SHUMË FAZA, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 62/2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor, me qasje programatike me shumë faza, ratifikuar me ligjin nr. 62/2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT SHTETËROR
DREJTORIA E MARRËVESHJEVE DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Mbi projektin “Për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor, me qasje programatike me shumë faza, ratifikuar me ligjin 62/2019”

ZYRËS SË BANKËS BOTËRORE
Bulevardi “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, nr. 34, Tiranë

I referohem Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e Projektit për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor, me qasje programatike me shumë faza, ratifikuar me ligjin nr. 62/2019.

Me qëllim vijueshmërinë me sukses të aktiviteteve për t’u financuar nga kjo marrëveshje, nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare për rishikimin e marrëveshjes së mësipërme si vijon:

1. Në nenin 3.01 “MFE” zëvendësohet me “Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)”;

2. Në nenin 6.01 “Ministër i Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohet me “ministër i Financave”;

3. Në nenin 6.02 “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohet me “Ministria e Financave”;

4. Në skedulin 2, seksioni I, A.1, “MFE” zëvendësohet me “MEKI”;

5. Në skedulin 2, seksioni I, A.1, (a), “MFE” zëvendësohet me “MEKI”;

6. Në skedulin 2, seksioni I, A.1, (b), “MFE” zëvendësohet me “MF”;

7. Në skedulin 2, seksioni I, B.1, “MFE” zëvendësohet me “MEKI”;

8. Në skedulin 2, seksioni II, 1, (a) “MFE” zëvendësohet me “MEKI”;

9. Në skedulin 2, seksioni II, 1, (b) “MFE” zëvendësohet me “MEKI”;

10. Në skedulin 2, seksioni II, 2, “MFE” zëvendësohet me “MEKI”;

11. Në shtojcë, pika 10, “MFE” zëvendësohet me “MF” dhe “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” të zëvendësohet me “Ministria e Financave”;

12. Në shtojcë të shtohet një pike e re 11 me përkufizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Kjo letër, së bashku me letrën tuaj të përgjigjes, do të përbëjnë Marrëveshjen Ndryshuese, me shkëmbim letrash të Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e Projektit “Për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor, me qasje programatike me shumë faza, ratifikuar me ligjin nr. 19/2017”.

Ky ndryshim hyn në fuqi pasi pala shqiptare të njoftojë Bankën Botërore për përfundimin e procedurave të brendshme.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të konfirmimit tuaj.

MINISTËR
Ervin Mete